



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË



“Për miratimin e Planit të Integritetit të Bashkisë Gjirokastrë për periudhën 2026-2028”

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar; Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar; Ligjit Nr.9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”; Vendim Nr. 874, datë 29.9.2021 “Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”; Ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”; Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative"; Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024-2030; Strategjisë Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030; Rekomandimeve të GRECO (Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit) për forcimin e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në administratën publike.

Në mbledhjen e datës 20/07/.2026, Këshilli i Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Për miratimin e Planit të Integritetit të Bashkisë Gjirokastrë për periudhën 2026-2028.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Bexhet Baxhella

KRYETAR I KËSHILLIT

Merita Isaraj

